

 **Kastrati sh.p.k**

**Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
**Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur**

## PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-3
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	5
PASQYRA E NDRYSHIMIT NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	7
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	8-34

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe Ortakun e Shoqërisë Kastrati sh.p.k

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Kastrati sh.p.k (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 5 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

### Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera. Informacione të tjera janë të gjitha informacionet e dhëna në raportin vjetor, përveç pasqyrave financiare, raportit të drejtimit dhe raportit të auditimit.

Opinioni ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe ne nuk ofrojmë asnjë siguri mbi to.

Si pjesë e auditimit, është përgjegjësia jonë të lexojmë këto informacione të tjera dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionet e marra gjatë auditimit tonë, ai përmban ndonjë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose ndonjë gabim material të dukshëm. Nëse konkludojmë se ekziston një gabim material të fakteve në informacione të tjera, duhet ta raportojmë atë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

29 qershor 2020



---

Teit Gjini  
Auditues Ligjor  
 M A Z A R S  
Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",  
No.5, 1000, Tirana, Albania  
phone: +355 42 27 80 15  
www.mazars.al - info@mazars.al

**KASTRATI SH.P.K**  
**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019**  
*(vlerat në LEK)*

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Aktivet afatgjata materiale	6	3,554,504,064	3,155,050,423
Aktivet afatgjata jomateriale	7	15,168,363	18,783,346
Parapagimet për aktive	8	5,848,271	5,927,574
Aktive afatgjata te tjera	9	50,000	-
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>3,575,570,698</b>	<b>3,179,761,343</b>
<b>Aktivet afatshkurtra</b>			
Inventarë	10	616,539,096	620,764,547
Llogari të arkëtueshme tregtare	11	1,615,503,477	1,172,427,351
Hua ndaj palëve te treta	26	12,532,815	42,719,147
Llogari të arkëtueshme të tjera	12	434,368,619	274,381,374
Parapagim i tatim fitimit	25	3,880,792	26,558,555
Mjetet monetare në arkë e në bankë	13	137,207,183	179,506,561
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>2,820,031,982</b>	<b>2,316,357,535</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>6,395,602,680</b>	<b>5,496,118,878</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali themeltar	14	544,367,000	544,367,000
Rezerva të tjera	15	2,409,006,867	1,946,087,300
Fitimi i ushtrimit		825,639,637	566,809,030
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>3,779,013,504</b>	<b>3,057,263,330</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Hua afatgjata	16	231,552,978	356,825,999
Detyrimi i qirasë	2	296,634,481	-
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>528,187,459</b>	<b>356,825,999</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Pjesa afatshkurter e huave	16	121,289,909	122,402,434
Detyrimi i qirasë	2	90,891,065	-
Llogari të pagueshme tregtare	17	757,921,041	1,152,464,176
Të ardhura të shtyra dhe parapagime tëmarra	18	997,768,900	668,580,937
Llogari të pagueshme të tjera	19	120,530,802	138,582,002
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>2,088,401,717</b>	<b>2,082,029,549</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>2,616,589,176</b>	<b>2,438,855,548</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>6,395,602,680</b>	<b>5,496,118,878</b>

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të Shoqërisë më 19 qershor dhe janë firmosur nga:

Shefit Kastrati  
 Administrator



Shënimet bashkëngjitur nga 1 në 30 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

KASTRATI SH.P.K.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(vlerat në LEK)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat	20	16,478,730,964	16,118,065,248
Kosto e mallrave të shitur	21	(14,220,504,049)	(14,343,270,112)
<b>Fitimi bruto</b>		<b>2,258,226,915</b>	<b>1,774,795,136</b>
Shpenzime administrative dhe operative	22	(1,146,861,939)	(1,092,198,700)
Provizion për borxhin e keq	11	(40,850,000)	(8,180,000)
Shpenzime financiare neto	23	(29,358,745)	13,093,696
Shpenzime të tjera	24	(62,459,589)	(6,747,917)
<b>Total shpenzime</b>		<b>(1,279,530,273)</b>	<b>(1,094,032,921)</b>
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>978,696,642</b>	<b>680,762,215</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		<b>(153,057,005)</b>	<b>(113,953,185)</b>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	25	(153,057,005)	(113,953,185)
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>825,639,637</b>	<b>566,809,030</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>825,639,637</b>	<b>566,809,030</b>

Shënimet bashkëngjitur nga 1 në 30 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

KASTRATI SH.P.K

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(vlerat në LEK)

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Totali
<b>Pozicioni financiar më 1 janar 2018</b>	<b>544,367,000</b>	<b>1,908,668</b>	<b>1,380,982,088</b>	<b>713,196,544</b>	<b>2,640,454,300</b>
Transferim në rezerva			563,196,544	(563,196,544)	-
Fitimi vitit				566,809,030	566,809,030
Dividendë të shpërndarë				(150,000,000)	(150,000,000)
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018</b>	<b>544,367,000</b>	<b>1,908,668</b>	<b>1,944,178,632</b>	<b>566,809,030</b>	<b>3,057,263,330</b>
Transferim në rezerva			562,919,567	(562,919,567)	-
Fitimi vitit				825,639,637	825,639,637
Dividendë të shpërndarë			(100,000,000)	(3,889,463)	(103,889,463)
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019</b>	<b>544,367,000</b>	<b>1,908,668</b>	<b>2,407,098,199</b>	<b>825,639,637</b>	<b>3,779,013,504</b>

Shënimet bashkëngjitur nga 1 në 30 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.



KASTRATI SH.P.K

Pasqyra e fluksit të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(vlerat në LEK)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi para tatimit	978,696,642	680,762,215
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	244,534,939	170,693,162
Shpenzime për interesa	23,252,735	15,832,067
Provigjion për borxhin e keq	40,850,000	8,180,000
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues;</i>		
Rënie/(rritje) në inventar	4,225,451	(57,688,434)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(613,727,039)	(53,052,207)
Rritje/(rënie) në të ardhurat e shtyra (Rënie)/rritje në llogari të pagueshme dhe të tjera	329,187,963	(238,435,298)
	(412,594,335)	177,749,385
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>	<b>594,426,356</b>	<b>704,040,890</b>
Interesa të paguara	(23,252,735)	(15,832,067)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(130,379,242)	(125,175,949)
	<b>(153,631,977)</b>	<b>(141,008,016)</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(639,269,747)	(379,749,924)
Parapagime për aktive afatgjata	79,303	-
Blerje të aktiveve afatgjata jomateriale	(1,103,850)	-
Investime në shoqëri bija	(50,000)	-
Parapagimi për aktive afatgjata	-	607,641
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>	<b>(640,344,294)</b>	<b>(379,142,283)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë	(126,385,546)	(52,543,074)
(Ripagim)/ të hyrat neto nga qiratë financiare	387,525,546	-
Dividendë të paguar	(103,889,463)	(150,000,000)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>	<b>157,250,537</b>	<b>(202,543,074)</b>
<b>Ndryshimi neto i mjeteve monetare</b>	<b>(42,299,378)</b>	<b>(18,652,483)</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës	179,506,561	198,159,044
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>137,207,183</b>	<b>179,506,561</b>

Shënimet bashkëngjitur nga 1 në 30 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare

## KASTRATI SH.P.K

### Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

#### 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Kastrati sh.p.k ("Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara e regjistruar në 27 prill 1995 me NIPT J61813529P me seli në adresën Lagja 14, Rruga Tirana, Shkozet, Durrës.

Shoqëria ka si aktivitet tregtimin e karburanteve, manaxhimin e bareve, restoranteve dhe dyqaneve zinxhirë në stacionet e shërbimit të saj. Shoqëria më 31 dhjetor 2019 operonte në 83 pikat e karburantit të regjistruara me numër identifikimi tatimor sekondar. Pikat e shërbimit ushtrojnë aktivitet në qytetet e mëdha duke qenë në këtë mënyrë të pranishme në të gjithë Shqipërinë.

Më 31 dhjetor 2019, aksionari i vetëm i Shoqërisë është Z. Shefqet Kastrati. Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 është 544,367,000 LEK me 544,367 aksione me vlerë nominale prej 1,000 secila.

Shoqëria më 31 dhjetor 2019 kishte 819 punonjës (31 dhjetor 2018: 765 punonjës). Numri i pikave të karburantit të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 është 83 (31 dhjetor 2018: 80).

Numri i punonjësve është ndarë sipas kategorive më poshtë :

- 2 Administratorë
- 50 Staf administrate (Financë, Menaxhim, IT, Shpërndarje toll etj)
- 80 Punonjës karburanti (Menaxher në pika dhe mbështetës)
- 635 Punonjës shërbimi (shitës, roje, etj)
- 52 Të tjerë

#### 2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

##### 2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

###### Aplikimi i SNRF 16 "Qiratë"

Shoqëria vlerëson nëse një kontratë është ose përmban element qiraje, në fillim të kontratës. Shoqëria njihet një të drejtë për të përdorur një aktiv dhe një detyrim korrespondues të qirasë në lidhje me të gjitha marrëveshjet e qirasë në të cilat ai aplikon, përveç qirave afatshkurtra (të përcaktuara si qira me një kontratë qiraje prej 12 muaj ose më pak) dhe qira e aseteve me vlerë të ulët (të tilla si tableta dhe kompjutera personalë, sende të vogla mobiljesh, zyra, automjete dhe telefona). Për këto qira, Shoqëria njihet pagesat e qirasë si një shpenzim operativ në baza lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë, përveç nëse një bazë tjetër sistematike është më përfaqësuese e modelit të kohës në të cilën konsumohen përfitimet ekonomike nga aktivet e dhëna me qira.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk paguhet në datën fillestare, këto të fundit të skontuara me normën e nënkuptuar në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, shoqëria përdor normën e huamarrjes.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë:

- o Pagesat e qirasë fikse (përfshirë pagesat fikse), minus çdo shumë e arkëtueshme nga qiraja;
- o Pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose normë, fillimisht e matur duke përdorur indeksin ose kursin në datën fillestare
- o Shuma që pritet të paguhet nga qiramarrësi nën garancitë e vlerës së mbetur;
- o Çmimi i ushtrimit të opsioneve të blerjes, nëse qiramarrësi është i sigurt për të ushtruar opsionet;
- o Pagesat e gjobave për ndërprerjen e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron ushtrimin e një opsioni për të përfunduar qiranë.

**2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)**

**2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)**

**Aplikimi i SNRF 16 "Qiratë" (vazhdim)**

Detyrimi i qirasë paraqitet si një zë i veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimi i qirasë matet më pas duke rritur vlerën kontabël për të reflektuar interesin mbi detyrimin e qirasë (duke përdorur metodën e interesit efektiv) dhe duke zvogëluar vlerën kontabël për të pasqyruar pagesat e qirasë së bërë.

Shoqëria ri-mat detyrimin e qirasë (dhe bën një rregullim përkatës ndaj aktivitet të lidhur me të drejtën e përdorimit) sa herë që:

Afati i qirasë ka ndryshuar ose ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim në rrethana që rezultojnë në një ndryshim në vlerësimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje. Në këtë rast detyrimi i qirasë rimatet duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të rishikuar zbritje.

Pagesat e qirasë ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në një indeks ose normë ose një ndryshim në pagesën e pritshme nën një vlerë të mbetur të garantuar, raste këto në të cilat detyrimi i qirasë rimatet duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të pandryshuar zbritje (përveç nëse pagesat e qirasë ndryshojnë për shkak të një ndryshimi në një normë interesi variabël, në këtë rast përdoret një normë e rishikuar e skontimit).

Nëse një kontratë qiraje modifikohet dhe modifikimi i qirasë nuk llogaritet si një qira e veçantë, në këtë rast detyrimi i qirasë rimatet bazuar në afatin e qirasë së qirasë së modifikuar, duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë, duke përdorur një normë të rishikuar zbritje në datën efektive të modifikimit. Aktivitet e përdorimit të së drejtës përfshijnë matjen fillestare të detyrimin përkatës së qirasë, pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit, minus çfarëdo pagese qiraje dhe çdo kosto fillestare direkte. Ato më pas maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi.

Kurdoherë që Shoqëria të bëjë një detyrim për shpenzimet për çmontimin dhe heqjen e një aktivi të dhënë me qira, dhe riposedon vendin në të cilin është vendosur ose rivendosur aktivi themelor në gjendjen e kërkuar nga termat dhe kushtet e qirasë, një provizion njihet dhe matet sipas SNK 37. Në atë masë që kostot lidhen me një aktiv të përdorimit të së drejtës, kostot përfshihen në aktivin e lidhur me të drejtën e përdorimit, përveç rasteve kur ato shpenzime janë bërë për të prodhuar inventarë.

Aktivitet e përdorimit të së drejtës zhvlerësohen gjatë periudhës më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet themelor. Nëse qiraja transferon pronësinë mbi aktivin themelor ose koston e aktivitet të së drejtës së përdorimit, ky aspekt reflekton faktin që Shoqëria pret të ushtrojë një mundësi blerjeje. Aktivi i lidhur me të drejtën e përdorimit zhvlerësohet gjatë jetës së dobishme të aktivitet themelor. Zhvlerësimi fillon në datën e fillimit të qirasë.

Aktivitet e përdorimit të së drejtës paraqiten si një zë i veçantë në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar.

Shoqëria aplikon SNK 36 për të përcaktuar nëse një aktiv i përdorimit të së drejtës është zhvlerësuar dhe përbën ndonjë humbje të identifikuar të zhvlerësimit, siç përshkruhet në politikën "Ndërtesa, Makineri dhe pajisje".

**KASTRATI SH.P.K**

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

*(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)***2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)****2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)****Aplikimi i SNRF 16 "Qiratë" (vazhdim)**

Qiratë e ndryshueshme që nuk varen nga një indeks ose normë nuk përfshihen në matjen e detyrimit të qirasë dhe aktivin e së drejtës së përdorimit. Pagesat e ndërlidhura njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ndodh ngjarja ose gjendja që shkakton ato pagesa dhe përfshihen në linjën "Shpenzime të tjera" në fitim ose humbje.

Si një praktikë e përdorshme, SNRF 16 lejon një qiramarrës të mos veçojë përbërësit jo-qira, dhe në vend të kësaj të llogarisë për çdo qira dhe komponentë që nuk lidhen me qira, si një marrëveshje e vetme. Shoqeria nuk e ka përdorur këtë praktikë. Për një kontratë që përmban një përbërës të qirasë dhe një ose më shumë komponentë të qirasë ose jo të qirasë, Shoqeria shpërndan vlerësimin në kontratë për secilin komponent të qirasë në bazë të çmimit relativ të pavarur të komponentit të qirasë dhe çmimit të agergat të pavarur të komponentëve jo-qira.

Kompania ka aplikuar qasjen e thjeshtuar të tranzicionit dhe nuk ka riparaqitur informacion krahasues, sic lejohet në parashikimet e vecanta të tranzicionit në standard. Kompania e njuh detyrimin e qerasë në lidhje me qeranë që ka qenë fillimisht klasifikuar si "qera operationale" sipas parimeve të SNK 17 Qeratë. Këto detyrime janë matur në vlerën e drejtë të mbetur të pagesave të qerasë, të skontuara me normën rritëse të huamarrjes me 1 janar 2019.

Tabela e mëposhtme paraqet maturimin e angazhimeve të qerasë operationale në detyrimin e njohur:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrimi për qiratë në pasqyrën e pozicionit financiar	<u>387,525,546</u>
Detyrimet afatshkurtra të qirasë	90,891,065
Detyrimet afatgjata të qirasë	<u>296,634,481</u>
<b><i>Shuma të njohura në të ardhura dhe shpenzime</i></b>	<b><i>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</i></b>
Shpenzime amortizimi të aktiveve me të drejta në përdorim	82,211,126
Shpenzimet e interesit (të përfshira në koston e financimit)	7,258,585
Shpenzime qeraje që lidhen me qira afatshkurtra	-
	<u>89,469,711</u>

## KASTRATI SH.P.K

### Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

## 2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

### 2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2019, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures – Amendimet e SNK
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2015- 2017
- Plani i ndryshimit ose zgjidhjes – Amendimet në SNK 19
- Interpretimi 23 Pasiguria mbi trajtimin e tatimit të të ardhurave
- KIRFN 23 Pasiguria mbi pozicionet e tatimit mbi të ardhurat (efektive nga 1 janar 2019)
- Përmirësimet vjetore (cikli 2015 -2017) (detyrimisht efektive për periudhën që fillon me 1 janar 2019)
- Amendimet në SNRF 9 Karakteristikat e parapagimit me kompensim negative (efektive nga 1 janar 2019)
- Amendimet në SNK 19 "Planet e ndryshimit, mbylljes ose zgjedhjes"(detyrimisht efektive për periudhat nga ose pas 1 janar 2019)
- Amendimet në SNK 28 "Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures" (detyrimisht efektive për periudhat me ose pas 1 janar 2019)
- SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" (detyrimisht efektive për periudhat me ose pas 1 janar 2021)

### 2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur me 31 dhjetor 2019:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zëvendësim i SNRF 4 Kontratat e sigurimeve – efektive për periudhat pas 1 janar 2021
- Amendimet e SNK 1 dhe SNK 8 – efektive për periudhat pas 1 janar 2020
- Amendimet e SNRF 3 – efektive për periudhat pas 1 janar 2020
- Kuadri konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar – efektive për periudhat pas 1 janar 2020

### 2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

## KASTRATI SH.P.K

### Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

#### 3. BAZAT E PËRGATITJES TE PASQYRAVE FINANCIARE

##### 3.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIFRN") të BSNK-së.

#### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL

##### 4.1. Monedha funksionale dhe raportuese

Monedha funksionale e Shoqërisë është Leku Shqiptar (LEK), e cila është monedha e përdorur në mjedisin ekonomik në të cilin Shoqëria ushtron veprimtarinë. Shoqëria përgatit dhe raporton pasqyrat e saj financiare në LEK. Transaksionet konvertohen fillimisht duke përdorur kursin e këmbimit midis monedhës së huaj dhe monedhës funksionale në momentin e kryerjes së veprimit që është momenti kur veprimi kualifikohet për njohje në pasqyrat financiare. Në fund të cdo periudhe raportuese, aktivet monetare konvertohen me kursin e fundit të periudhës raportuese. Aktivet jo-monetare mbahen me kosto historike dhe konvertohen në monedhën raportuese me kurset historike të transaksioneve.

Kurset e këmbimit të LEK-ut përkundrejt monedhave të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si në vijim:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
USD / LEK	108.64	107.82
EURO / LEK	121.77	123.42

Për aktivet monetare diferencat që rezultojnë nga konvertimi reflektohen në rezultatin e vitit. Kur diferencat rezultojnë nga zëra jomonetarë ato kalojnë në fitim ose humbje; çfarëdo diference e realizuar nga këmbimet valutore kalon në rezultatin e periudhës. Kur fitimi dhe humbja e zërave jomonetarë njihen në kapitalin neto, edhe diferencat nga këmbimet njihen në kapitalin neto.

##### 4.2. Inventari

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis kostos së tyre dhe vlerës neto të realizueshme. Kostot e inventarit përfshijnë të gjitha kostot e blerjes dhe të tjera që lindin gjatë procesit të sjelljes së inventarit në gjendjen dhe vendodhjen aktuale. Cdo zbritje tregtare e aplikuar në blerje do të zbritet në përcaktimin e kostos së blerjes së inventarit.

Nëse, për arsye të ndryshme përfshi këtu dëmtimin ose mospërdorimin, vlera neto e rikuperueshme e inventarit bie nën koston e saj, diferenca kalon menjëherë si shpenzim në rezultatin e vitit.

Meqë metoda e vlerësimit me njësi është e papërshtatshme, Shoqëria e vlerëson inventarin e saj nëpërmjet formulës së kostos Hyrje e parë – Dalje e parë ("First in First out" ose FIFO).

Kosto e inventarëve të përdorur nga Shoqëria dhe që nuk u shitet palëve të treta kapitalizohet si pjesë e një aktivi tjetër. Kosto e tyre njihet si shpenzim nëpërmjet zhvlerësimit të aktiveve.

##### 4.3. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë llogari rrjedhëse bankare, para në dorë, depozita me bankat dhe të tjera mjete që janë likuide dhe maturiteti i tyre i mbetur në një datë raportimi nuk është më shumë se 3 muaj.

#### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.4. Instrumenta financiare

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

**Instrumentat financiare – njohja fillestare.** Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes.** Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit.** Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrë se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

**Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare.** Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

**Aktivet financiare – pakësimi i vlerës.** Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

#### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.4. Instrumenta financiare (vazhdim)

**Aktivet financiare – çregjistrimi.** Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësisive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

**Detyrimet financiare – kategorite e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

**Detyrimet financiare – çregjistrimi.** Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

**Kompensimi i instrumenteve financiare.** Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohen shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.



#### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.4. Instrumenta financiare (vazhdim)

###### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së konsolidua të fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

###### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

###### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Për llogaritë e pagueshme, të pa paguara dhe të pa kërkuara për më shumë se pesë vjet për të cilat shoqëria bazuar në të dhënat dhe komunikimin me palën tjetër nuk ka ndonjë pritshmëri për shlyerjen e këtyre detyrimeve, gjykon se detyrimet e mësipërme nuk duhen njohur si të tilla por i njeh si të ardhura të vitit që vijnë nga fshirja e tyre.

###### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes të koston së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skonton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose, kur është e pershtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

###### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuara, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

###### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

###### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

## KASTRATI SH.P.K

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

---

### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

#### 4.4. Instrumenta financiare (vazhdim)

##### *Zhvlërësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlërësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlërësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlërësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlërësimi njihen në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlërësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivist me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlërësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 4.5. Aktive financiare

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera janë aktive financiare që përfaqësojnë një të drejtë kontraktuale për të marrë para në të ardhmen.

Llogari të arkëtueshme, hua dhe kredi të tjera janë aktive financiare jo derivative me interesa fikse ose me pagesa të paracaktuara të cilat nuk janë të kuotuar në tregje financiare dhe janë matur me kosto duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke i pakësuar për çdo humbje nga rënia në vlerë.

#### 4.6. Detyrime financiare

Detyrimet financiare përfaqësojnë llogari të pagueshme dhe të tjera, kredi dhe hua të tjera nga institucione financiare dhe të tretët.

Instrumentat financiarë klasifikohen si detyrime financiare në përputhje me substancën e marrëveshjeve kontraktuale dhe përcaktimet e një detyrimi financiar.

Detyrimet financiare (përfshi llogaritë e pagueshme dhe të tjera) maten pas njohjes duke i amortizuar me normën efektive të interesit.

#### 4.7. Aktive afatgjata materiale

##### 4.7.1 Njohja

Aktivet afatgjata materiale njihen nëse dhe vetëm nëse është e mundur që Shoqëria në të ardhmen të ketë përfitime ekonomike nga ky aktiv dhe kostot e krijimit të mund të maten. Elementë të tillë si: pjesë këmbimi, pajisje dhe makineri ndihmëse njihen si aktiv afatgjatë material kur plotësojnë kriterin për kapitalizim nga Shoqëria. Në rast të kundërt ato njihen dhe trajtohen si inventarë.

Nëse kriteret për njohje të aktivitetit plotësohen, kostot që lindin më vonë për të shtuar, zëvendësuar ose riparuar aktivin afatgjatë material i shtohen vlerës së mbetur të aktivitetit. Nëse kriteret për njohje nuk përmbushen, atëherë këto kosto do të jenë shpenzime të periudhës në të cilën ndodhin.

## KASTRATI SH.P.K

### Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

#### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.7. Aktive afatgjata materiale (VAZHDIM)

###### 4.7.2 Matja pas njohjes

Kur një element i aktiveve afatgjata materiale kualifikohet për t'u njohur si një aktiv, fillimisht matet me koston e tij.

Në rastin e një aktivi të blerë, kosto përfshin cmimin e blerjes bashkë me tarifën doganore dhe taksa të tjera të parimbursueshme, zbritjet në faturë dhe rabate, koston e transportit, koston e instalimit dhe cdo kosto tjetër që kryhet për t'a sjellë aktivin në vendodhjen dhe gjendjen e nevojshme për t'u vënë në punë. Për aktive të ndërtuara vetë, koston përfshijnë materiale direkte të përdorura, koston e punës së punëtorëve dhe kosto të cilat janë direkt të lidhura me ndërtimin e aktivit si dhe kosto financiare të kredimarrjeve për ndërtimin e aktivit. Çdo fitim i brendshëm i krijuar gjatë këtij procesi eliminohet në përcaktimin e koston së aktivit.

Shtimi i kostove në vlerën e mbetur të një elementi të aktiveve afatgjata materiale ndalon kur aktivi vihet në vendodhjen dhe është në gjendjen e duhur për t'u vënë në punë. Normat e amortizimit në përqindje të aktiveve afatgjata materiale për vitet e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është vlerësuar të jetë si më poshtë:

	%
Ndërtesa dhe instalime	5
Permirësime të objekteve me qira	5
Pajisje dhe makineri	20
Mjete transporti	20
Mobilje dhe pajisje zyre	20
Pajisje informatike	25

Zhvlerësimi përlogarit mbi vlerën e mbetur të aktivit. Toka nuk zhvlerësohet.

##### 4.8. Aktive afatgjata jomateriale

###### 4.8.1 Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata jomateriale me një jetëgjatësi të paracaktuar mbahen me kosto duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë. Amortizimi njihet sipas metodës lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve rishikohet në fund të cdo periudhe raportuese duke konsideruar çfarëdo lloj ndryshimi dhe efektet e saj si ndryshim në vlerësimet kontabël dhe duke e aplikuar për periudhat e ardhshme. Aktivet afatgjata jomateriale me një jetëgjatësi të pacaktuar mbahen me kosto duke i zbritur humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

## KASTRATI SH.P.K

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

#### 4.9. Rënia në vlerë e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale

Shoqëria rishikon në fund të çdo periudhe raportimi vlerën e mbetur të aktiveve të saj materiale dhe jomateriale për të evidentuar rrethana që do të sillnin rënie në vlerën e tyre. Nëse rrethana të tilla ekzistojnë, atëherë Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitetit për të evidentuar sipas rastit humbjet nga rënia në vlerë.

Nëse vlera e rikuperueshme e aktivitetit rezultojnë të jetë më e vogël se vlera e mbetur, atëherë kjo e fundit zvogëlohet deri sa të barazojë vlerën e rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë njihet direkt në rezultatin e vitit përveç rasteve kur aktiviteti është mbajtur me vlerën e rivlerësuar. Në këtë rast humbja nga rënia në vlerë do të njihet si ulje e rezervës së rivlerësimit të krijuar më parë.

Nëse në të ardhmen rezultojnë një rritje në vlerën e aktivitetit, vlera e mbetur e tij do të rritet deri në masën e humbjes që është njohur më parë duke e sjellë aktivitetin në një vlerë të mbetur jo më të lartë se sa vlera që kishte para se të pësonte në të kaluarën humbje nga rënia në vlerë.

#### 4.10. Të ardhurat

Të ardhura konsiderohen hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat lindin si pasojë e veprimtarisë dhe aktivitetit normal të Shoqërisë. Të ardhurat përfshijnë elementë të tillë si shitje, tarifa shërbimi, interesa dhe qira.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur: (i) Shoqëria i ka transferuar blerësit rreziqet dhe përfitime të konsiderueshme në lidhje me pronësinë e mallrave; (ii) Shoqëria nuk mban asnjë të drejtë dhe nuk është e përfshirë në administrimin e mallrave sic ndodh kur ka pronësinë; (iii) vlera e të ardhurave mund të matet; (iv) është e mundur që Shoqëria do të marrë përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin dhe kostot e ndodhura ose që do të ndodhin lidhur me transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme.

E ardhura matet me vlerën e drejtë të përfitimeve të marra ose të arkëtueshme. Vlera e të ardhurave njihet neto nga zbritjet tregtare ose rabatet e marra.

#### 4.11. Shpenzime huamarrje

Të gjitha shpenzimet e huamarrjeve dhe shpenzimet financiare të tjera njihen direkt në rezultatin e vitit në momentin kur ndodhin.

#### 4.12. Tatim fitimi

Shpenzimi për tatim fitimin përfaqëson totalin e tatim fitimit të periudhës. Shpenzimi i vitit për tatim fitimin përllëgaritet duke përdorur normën e tatim fitimit e cila është e aplikueshme në fund të periudhës raportuese.

Shpenzimi për tatim fitimin është njohur në rezultatin e vitit.

#### 4.13. Informacioni krahasues

Të dhëna krahasuese janë riklasifikuar kur ka qënë e nevojshme, në përputhje me ndryshimet në prezantimin në periudhën aktuale. Megjithatë, këto riklasifikime nuk kanë rezultuar në ndryshime të rëndësishme të përmbajtjes dhe paraqitjen e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare.

## 5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

### *Vlerësimi i modelit të biznesit*

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi. Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Gjatë kalimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje aktiviteti financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezulton nga shkeljet e kriterëve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore. Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

### *Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")*

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesi kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

### *Matjet humbjeve të parashikuara të kredisë*

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

### *Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë*

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj..) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

**KASTRATI SH.P.K**
**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**
*(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)*
**6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

	Toka, troje dhe terrere	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike dhe zyre	Punime per ambiente me qira	Asete me Qera Financiare Automjete	Aktive ne perodanim (IFRS 16)	Të tjera	Totali
<b>Kosto</b>										
Gjendja më 1 janar 2018	916,420,441	1,672,915,060	358,091,298	29,727,193	173,184,614	113,732,830	26,745,780	-	39,387,661	3,330,204,877
Shtesa	168,374,200	145,654,300	37,140,178	3,057,859	6,021,824	-	20,188,800	-	-	380,437,161
Pakësime	-	-	(499,322)	(436,576)	(116,665)	-	-	-	-	(1,052,563)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,084,794,641	1,818,569,360	394,732,154	32,348,476	179,089,773	113,732,830	46,934,580	-	39,387,661	3,709,589,475
Shtesa	19,875,750	104,418,402	19,138,721	919,725	11,306,297	-	-	480,271,530	4,098,787	640,029,212
Pakësime	-	-	-	(2,669,408)	-	-	-	-	-	(2,669,408)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,104,670,391	1,922,987,762	413,870,875	30,598,793	190,396,070	113,732,830	46,934,580	480,271,530	43,486,448	4,346,949,279
<b>Amortizimi i akumuluar</b>										
Gjendja më 1 janar 2018	-	135,114,480	133,014,135	15,123,481	78,294,378	15,278,685	8,577,690	-	3,920,975	389,323,824
Amortizimi i vitit	-	78,802,461	47,693,864	3,532,314	21,861,961	5,538,389	4,693,458	-	3,458,107	165,580,554
Pakësime	-	-	(132,403)	(232,923)	-	-	-	-	-	(365,326)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	213,916,941	180,575,596	18,422,872	100,156,339	20,817,074	13,271,148	-	7,379,082	554,539,052
Amortizimi i vitit	-	82,820,063	39,401,826	2,975,579	18,312,259	5,686,641	6,732,687	82,211,126	1,675,925	239,816,106
Pakësime	-	-	-	(1,909,943)	-	-	-	-	-	(1,909,943)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	296,737,004	219,977,422	19,488,508	118,468,598	26,503,715	20,003,835	82,211,126	9,055,007	792,445,215
<b>Vlera neto kontabël</b>										
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,084,794,641	1,604,652,419	214,156,558	13,925,604	78,933,434	92,915,756	33,663,432	-	32,008,579	3,155,050,423
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,104,670,391	1,626,250,758	193,893,453	11,110,285	71,927,472	87,229,115	26,930,745	398,060,404	34,431,441	3,554,504,064

**KASTRATI SH.P.K****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)***6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)**

Më 31 dhjetor 2019, toka dhe ndërtesat me një vlerë kontabël neto prej 1,104,670,391 LEK (31 dhjetor 2018: 1,084,794,641 LEK ) dhe 1,626,250,758 LEK (31 dhjetor 2018: 1,604,652,420 LEK) respektivisht, janë vendosur si kolateral në favor të bankave vendase për kredi dhe forma të tjera financimi të Shoqërisë ose dhe të palëve të lidhura.

Drejtimi nuk ka identifikuar ndonjë tregues të zhvlerësimit mbi aktivet afatgjata të Shoqërisë. Për shkak të rritjes së përfitueshmërisë së Shoqërisë dhe të faktit se shumica e pikave të shitjes janë të reja, nuk është njohur asnjë zhvlerësim mbi aktivet afatgjata materiale në këto pasqyra financiare.

**7. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE**

	<b>AAJM</b>
<b>Me kosto</b>	
Gjendja më 1 janar 2018	54,439,856
Shtesa	-
<hr/>	
Gjendja më 31 dhjetor 2018	54,439,856
Shtesa	1,103,850
Pakësime	-
<hr/>	
Gjendja më 31 dhjetor 2019	55,543,706
<b>Amortizimi</b>	
Gjendja më 1 janar 2018	30,543,902
Amortizimi i vitit	5,112,608
<hr/>	
Gjendja më 31 dhjetor 2018	35,656,510
Amortizimi i vitit	4,718,833
<hr/>	
Gjendja më 31 dhjetor 2019	40,375,343
<hr/>	
Gjendja neto më 31 dhjetor 2018	18,783,346
<hr/>	
Gjendja neto më 31 dhjetor 2019	15,168,363

Aktivitet afatgjata jomateriale përfaqësojnë sisteme dhe programe me jetëgjatësi të përcaktuar.

**8. PARAPAGIME PËR AKTIVE**

Parapagimet më 31 dhjetor 2019 në shumën 5,848,271 LEK (31 dhjetor 2018: 5,927,574 LEK) përfaqësojnë parapagimet e bëra furnitorëve për blerjen e aktiveve afatgjata materiale si: toka, ndërtesa e pika karburanti dhe aktive afatgjata materiale të tjera.

**9. AKTIVE AFATGJATA TE TJERA**

Aktive afatgjata të tjera më 31 dhjetor 2019 në vlerën 50,000 Lek (2018 :0) përfaqëson vlerën kuotës së blerë në shoqërinë ASALB. shpk. Kuota e Shoqërisë përfaqëson 50% pjesëmarrje në kapitalin e ASALB. shpk.

**KASTRATI SH.P.K****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)***10. INVENTARË**

Inventarët më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Karburant për shitje	521,525,606	528,572,821
Inventarë të tjerë për shitje	95,013,490	92,191,726
	<u>616,539,096</u>	<u>620,764,547</u>

Inventarë të tjerë për shitje përbëhen kryesisht nga mallrat për shitje që ndodhen në marketet, baret dhe në restorantet e Shoqërisë.

**11. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA KLIENTË**

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të arkëtueshme nga klientë	1,896,660,256	1,412,734,130
Provizjion për borxhin e keq	(281,156,779)	(240,306,779)
	<u>1,615,503,477</u>	<u>1,172,427,351</u>

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë të arkëtueshmet nga klientët për shitjen e karburantit dhe produkteve të tjera nga aktiviteti kryesor i Shoqërisë. Lëvizja në provizionin për borxhin e keq deri më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Gjendja më 1 janar	240,306,779	27,747,124
Korrigjime për efekt të SNRF 9	-	204,379,655
Gjendja në fillim e perlllogaritur ne perputhje me SNRF 9	240,306,779	232,126,779
Zhvlerësimi për vitin	40,850,000	8,180,000
Gjendja më 31 dhjetor	<u>281,156,779</u>	<u>240,306,779</u>

**12. LLOGARI TË ARKËTUESHME TË TJERA**

Llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të arkëtueshme nga palë të treta	302,759,266	116,075,877
TVSH e rimbursueshme (pagueshme)	-	25,591,605
Parapagime per furnitoret	129,809,754	130,040,814
Parapagime te ndryshme	1,799,599	2,673,078
	<u>434,368,619</u>	<u>274,381,374</u>

Të arkëtueshme nga palë të treta në 31 dhjetor 2019 përfaqëson ndihmë afatshkurtër me të drejtë kthimi ndaj palëve të treta.



**KASTRATI SH.P.K****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)***13. MJETE MONETARE NË ARKË DHE BANKË**

Mjete monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Para në bankë	82,837,311	109,106,511
Para në arkë	54,369,872	70,400,050
	<u>137,207,183</u>	<u>179,506,561</u>

**14. KAPITALI**

Më 31 dhjetor 2019 aksionari i vetëm i Shoqërisë është Z. Shefqet Kastrati. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është 544,367,000 LEK me 544,367 aksione me vlerë nominale prej 1,000 secila.

**15. REZERVA**

Rezerva ligjore të krijuara nga Shoqëria deri më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 kanë një vlerë prej 1,908,668 LEK. Rezervat e tjera janë krijuar nga Shoqëria dhe nuk janë të detyrueshme dhe nuk duhen konsideruar si rezerva ligjore. Rezervat e tjera të krijuara nga Shoqëria deri më 31 dhjetor 2019 kanë një vlerë prej 2,407,098,199 LEK (31 dhjetor 2018: 1,944,178,632 LEK).

**16. HUA BANKARE DHE TË TJERA**

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua Bankare	341,167,930	459,611,603
Qira financiare mjete transporti	11,674,957	19,616,830
	<u>352,842,887</u>	<u>479,228,433</u>

Në 11 nëntor 2016 Shoqëria ka marrë një kredi nga një bankë tregtare lokale për shumën principale prej 3,000,000 EURO për të financuar blerjen e një prone. Kredia afatgjatë ka normë interesi variabël i cili rishikohet çdo vit. Gjithashtu në dhjetor të 2017 Shoqëria ka marrë një financim me afat shlyerje 7 vite prej 1,500,000 EURO për blerjen e një pike karburanti.

Qira financiare përfaqësojnë detyrimin për qira financiare të marrë për blerjen e disa automjeteve të Shoqërisë.

Hua dhe kreditë e tjera me afat më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë ndarë sipas maturitetit të mbetur si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Afatgjatë	231,552,978	356,825,999
Afatshkurtër	121,289,909	122,402,434
	<u>352,842,887</u>	<u>479,228,433</u>

**KASTRATI SH.P.K****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)***17. LLOGARI TË PAGUESHME**

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë për karburant dhe të tjera	569,278,206	873,784,143
Aktive afatgjata materiale dhe të tjera	188,642,835	278,680,033
	<u>757,921,041</u>	<u>1,152,464,176</u>

Llogaritë e pagueshme përbëhen kryesisht nga të pagueshme ndaj furnitorëve për blerjen e karburantit dhe nënprodukteve, blerjen e aktiveve fikse dhe balancave të tjera që lidhen me aktivitetin tregtar të Shoqërisë.

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë ndarë sipas pritshmërisë së shlyerjes si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Afatgjatë	-	-
Afatshkurtër	757,921,041	1,152,464,176
	<u>757,921,041</u>	<u>1,152,464,176</u>

**18. TË ARDHURA TË SHTYRA**

Të ardhura të shtyra përfaqësojnë balancën e marrë paradhënie nga klientët për shitjen e karburantit me tollon. Shoqëria ka pritshmëri ti realizojë këto tollona në një hark kohor jo më të gjatë se 12 muaj pas fundit të vitit.

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura të shtyra	997,768,900	668,580,937
	<u>997,768,900</u>	<u>668,580,937</u>

**19. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA**

Logari të pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	9,982,334	9,178,749
Tatim mbi të ardhurat personale	1,552,132	1,405,075
Divident te pagueshem	70,338,332	127,500,000
Detyrime të tjera	573,295	498,178
TVSH e pagueshme	38,084,709	-
	<u>120,530,802</u>	<u>138,582,002</u>

**KASTRATI SH.P.K****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)***20. TË ARDHURA**

Të ardhurat për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë gjeneruar nga aktivitetet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shitja e karburantit	15,774,179,219	15,561,990,685
Komisionet e shërbimit	2,172,057	-
Aktivitete të tjera	702,379,688	556,074,563
	<u>16,478,730,964</u>	<u>16,118,065,248</u>

Komisionet e shërbimit janë komisione shitjeje të përfituara në bazë të kontratave të furnizimit me karburant. Të ardhurat nga aktivitete të tjera përfaqësojnë përfitime nga marketet që gjenden në pikat e shërbimit, bare, restorante etj.

**21. KOSTO E MALLIT TË SHITUR**

Kosto e mallit të shitur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Kosto e karburantit të shitur	13,700,758,610	13,929,856,101
Kosto nga aktivitete të tjera	519,745,439	413,414,011
	<u>14,220,504,049</u>	<u>14,343,270,112</u>

Kosto të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 në vlerë 519,745,439 LEK (2018: 413,414,011 LEK) përfaqësojnë kosto të tjera direkte, koston e produkteve të shitur nga marketet në pikat e shërbimit, bare, restorante etj.

**KASTRATI SH.P.K****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)***22. SHPENZIME ADMINISTRATIVE DHE OPERATIVE**

Shpenzimet administrative dhe operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime personeli	489,068,016	443,589,515
Amortizimi	244,401,469	170,693,162
Qera	-	89,020,519
Shpenzime energji, uje, karburant te tjera	43,253,197	76,687,373
Mirëmbajtja dhe riparimi	78,758,337	54,103,051
Shpenzime per bonus klienteve	66,157,557	66,509,134
Taksa të ndryshme	29,514,076	36,784,659
Shpenzime për kontroll teknik	11,256,482	10,706,944
Shpenzime marketing dhe promocioni	13,584,858	34,288,903
Sigurime dhe shpenzime të lidhura me to	12,438,866	10,477,937
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	17,832,536	11,791,808
Shpenzime profesionale	4,695,328	4,128,659
Veshje pune, materiale per punonjesit	14,787,303	21,075,114
Shpenzime transporti dhe te ngjashme	4,352,030	3,928,534
Shpenzime të tjera administrative	116,761,884	58,413,388
	<u><b>1,146,861,939</b></u>	<u><b>1,092,198,700</b></u>

Shpenzime të tjera administrative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 me vlerë 116,761,884 LEK (2018: 58,413,388 LEK) përfaqësojnë shpenzime për riparime të vogla, materiale konsumi dhe pastrimi, kanceleri, tollona leter, karta për klientët, letra për kasat fiskale, dieta per personelin, memorje fiskale dhe të tjera shpenzime të natyrave të ndryshme.

Sherbimet e dhenies se sigurise dhe auditim nga shoqeria Mazars per vitin 2019 eshte ne vlere 961,904 Lek.

**23. SHPENZIME FINANCIARE, NETO**

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Humbje neto nga kurset e këmbimit	(491,565)	(34,626,383)
Shpenzime interesi neto	23,252,735	15,832,067
Komisione dhe tarifa bankare	6,597,575	5,700,620
	<u><b>29,358,745</b></u>	<u><b>(13,093,696)</b></u>

KASTRATI SH.P.K

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

24. SHPENZIME TË TJERA, NETO

Shpenzimet të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Donacione	48,862,500	1,695,120
Gjoha dhe penalitete	11,368,247	4,236,552
Shpenzime të tjera	2,035,907	978,925
Te ardhura nga shitja e aktiveve	192,935	(162,680)
	<u>62,459,589</u>	<u>6,747,917</u>

25. TATIM FITIMI

Shpenzimi për tatim fitimin

Shpenzimi për tatim fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është përllogaritur si në vijim:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Fitimi para tatimit</i>	<u>978,696,642</u>	<u>680,762,215</u>
<i>Diferenca të përkohshme për të cilat nuk është njohur tatim i shtyrë:</i>	<u>30,315,142</u>	<u>8,180,000</u>
Provizion për borxhin e keq	40,850,000	8,180,000
Rikthim per SNRF 16	(10,534,858)	
<b>Total shpenzime të panjohura</b>	<u>11,368,247</u>	<u>70,745,686</u>
Bonuse dhene klienteve	-	66,509,134
Gjoha dhe penalitete	11,368,247	4,236,552
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>1,020,380,031</u>	<u>759,687,901</u>
Humbje fiskale e mbartur	-	-
<i>Tatim fitimi @15%</i>	<u>153,057,005</u>	<u>113,953,185</u>
	<u>825,639,637</u>	<u>566,809,030</u>

Pozicioni i të drejtave/(detyrimeve) për tatim fitimin detajohet si më poshtë:

	2019	2018
Gjendja më 1 janar	26,558,555	15,335,791
Paguar gjatë vitit	130,379,242	125,175,949
Shpenzimi vitit	(153,057,005)	(113,953,185)
Gjendja më 31 dhjetor	<u>3,880,792</u>	<u>26,558,555</u>

**KASTRATI SH.P.K****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)***26. HUA ME PALET E LIDHURA**

Huatë me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua palëve të treta	12,532,815	42,719,147
	<u>12,532,815</u>	<u>42,719,147</u>

**27. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA**

Palë të lidhura me Shoqërinë konsiderohen:

(a) individë ose anëtarë të afërm të familjes së tyre të cilët: (i) zotërojnë kontroll mbi Shoqërinë individualisht ose bashkarisht; (ii) kanë influencë të konsiderueshme mbi veprimtarinë e Shoqërisë; ose (iii) janë anëtarë të manaxhimit kryesor të Shoqërisë.

(b) entitete për të cilët plotësohet një nga kushtet: (i) entiteti dhe Shoqëria janë anëtarë të të njëjtit grup; (ii) njëra nga entitetet është një filial ose investim i një pale të tretë; (iii) të dy entitetet janë investim nga e njëjta palë e tretë; (iv) një entitet është investim i një pale të treta dhe ky i fundit është filial i tij; (v) entiteti është një plan përfitim pas-punësimit për të mirën e të punësuarve e Shoqërisë ose një entiteti i lidhur me Shoqërinë; (vi) entiteti kontrollohet ose ka kontroll të përbashkët nga një individ që përmbush kriterin (a); dhe (vii) një individ sipas kriterit (a), (i) që ka influencë mbi entitetin ose është anëtar i manaxhimit kryesor të Shoqërisë.

**27.1 Veprime në lidhje me aktivitetin**

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018, shoqëria ka pasur veprime me palë të lidhura për aktivitetin e saj si më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
<b>Blerje mallrash dhe/ose shërbimesh:</b>		
Shoqëri në pronësi të aksionarit të vetëm	15,451,519,922	15,877,845,206
Shoqëri ku aksionari i vetëm ka kontroll	15,885,266	14,273,913
Shoqëri të tjera të lidhura	15,790,699	15,040,828
	<u>15,483,195,887</u>	<u>15,907,159,947</u>
<b>Shitje mallrash dhe/ose shërbimesh:</b>		
Shoqëri në pronësi të aksionarit të vetëm	1,206,093,693	681,325,219
Shoqëri ku aksionari i vetëm ka kontroll	56,920,219	47,815,203
Shoqëri të tjera të lidhura	22,712,755	37,102,940
	<u>1,285,726,667</u>	<u>766,243,362</u>

Shitje mallrash dhe/ose shërbimesh ndaj palëve të lidhura janë bërë me çmimet që Shoqëria zbaton me palë të treta duke bërë zbritje në varësi të volumeve dhe produkteve.

Blerjet janë bërë me çmimet e tregut të zbritura këto për të reflektuar cilësinë e produkteve si dhe marrëdhënien e biznesit mes palëve.

**KASTRATI SH.P.K****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)***27. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)**

Tepricat e mbetura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 me palë të lidhura të Shoqërisë janë detajuar si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
<b>Llogari të arkëtueshme:</b>		
Shoqëri në pronësi të aksionarit të vetëm	233,572,516	132,474,196
Shoqëri ku aksionari i vetëm ka kontroll	61,208,354	76,266,722
Shoqëri të tjera të lidhura	47,238,367	32,061,848
	<u>342,019,237</u>	<u>240,802,766</u>
<b>Llogari të pagueshme:</b>		
Shoqëri në pronësi të aksionarit të vetëm	214,493	114,639,908
Shoqëri ku aksionari i vetëm ka kontroll	-	22,167,430
Shoqëri të tjera të lidhura	11,915,468	153,996
	<u>12,129,961</u>	<u>136,961,334</u>

Vlerat e mbetura në fund të vitit, do të shlyen përkatësisht sipas natyrës. Në lidhje me këto vlera nuk ka garanci të marra ose të dhëna.

**27.2 Kompensime ndaj manaxhimit**

Kompensimet ndaj drejtorëve dhe manaxhimit kryesor të Shoqërisë gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Përfitime afatshkurtra	1,732,700	1,740,000
	<u>1,732,700</u>	<u>1,740,000</u>

## KASTRATI SH.P.K

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

### 28. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Risku financiar përfshin riskun e tregut (riskun ndaj kurseve të këmbimit dhe normave të interesit), riskun e kreditimit dhe riskun e likuiditetit. Manaxherët e riskut të Shoqërisë monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe manaxhojnë ekspozimin ndaj riskut financiar që lidhet me veprimtarinë e Shoqërisë nëpërmjet raportimeve të brendshme, analizave të ekspozimit sipas rastit etj.

#### 28.1 Manaxhimi i riskut të tregut

##### (i) Manaxhimi i riskut ndaj kurseve të këmbimit

Shoqëria gjatë aktivitetit të saj kryen veprime të limituara në monedha të huaja, për rrjedhojë. Shoqëria nuk është e ekspozuar ndjeshëm ndaj riskut të ndryshimit të kurseve të këmbimit. Vlera e mbetur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 e aktiveve dhe detyrimeve monetare të Shoqërisë në valutë janë si në vijim:

	Aktive monetare		Detyrime monetare	
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
LEK	2,027,878,261	1,520,057,666	1,750,341,941	1,572,608,313
EUR	176,669,089	176,669,089	863,255,786	863,255,786
USD	4,793,807	4,793,807	2,991,449	2,991,449
	<u>2,209,341,157</u>	<u>1,701,520,562</u>	<u>2,616,589,176</u>	<u>2,438,855,548</u>

##### (ii) Manaxhimi i riskut të normave të interesit

Shoqëria ekspozohet ndaj riskut që lidhet me normat e interesit për instrumentat financiarë të borxhit të cilat mbartin interes. Shoqëria e manaxhon këtë risk duke mbajtur një proporcion të arsyeshëm midis instrumentave të borxhit me interes fiks dhe atyre variabël.

Për shkak se, termat kontraktuale të instrumentave financiarë të borxhit kanë interesa dysheme të aplikuara, nëse normat e tregut do të rriteshin me 0.5 pike, ndërkohë që variablat e tjere do të mbeteshin të pandryshuara, kjo rritje nuk do të kishte asnjë ndikim material në rezultatin e Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

Ekspozimi dhe ndjeshmëria që ka Shoqëria ndaj ndryshimit të normave të interesit ka rënë si rezultat i rënies së vlerave të mbetura të kredive me interes variabël.

#### 28.2 Manaxhimi i riskut të kreditimit

Risku i kreditimit i referohet riskut që ka Shoqëria nëse një palë e tretë në pamundësi të shlyerjes së detyrimeve i shkakton asaj një humbje financiare.

Llogaritë e arkëtueshme përbëhen nga një numër i konsiderueshem klientësh që veprojnë në industri të ndryshme. Në menyrë të vazhdueshme Shoqëria bën vlerësim të masës së kreditimeve ndaj klientëve dhe sipas rastit mban dhe garanci për vlerën e furnizimeve. Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj një klienti në vecanti.



## 28. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### 28.3 Manaxhimi i riskut të likuiditetit

Shoqëria e manaxhon riskun e likuiditetit duke mbajtur një nivel të mjaftueshëm rezervash, limitesh bankare për kredi dhe instrumenta financiare të tjerë, duke monitoruar vazhdimisht parashikimet dhe flukset aktuale të parasë si dhe duke përputhur maturimin e aseteve dhe detyrimeve të saj financiare.

Shoqëria ka financuar aktivitetin e saj nëpërmjet kontributit të aksionarit ose flukseve monetare të gjeneruara nga aktiviteti. Si rezultat i kësaj, Shoqëria nuk është e ekspozuar ndjeshëm ndaj rrezikut të kredisë.

Tabela në vijim detajon maturimin e pritshëm të aktiveve financiare jo derivativë të Shoqërisë.

Në mënyre që të kuptohet ekspozimi ndaj riskut të likuiditetit të Shoqërisë, meqë likuiditetet manaxhohen duke marrë efektin neto mes aktiveve dhe detyrimeve financiare, tabela është krijuar duke zbritur nga aktivet financiare vlerën e detyrimeve financiare dhe duke marrë në konsideratë çdo lloj interesi që do të fitohej/paguhej sipas termave kontraktuale për ato aktive dhe detyrime.

**KASTRATI SH.P.K**

**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

*(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)*

**28. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**28.3 Manaxhimi i riskut të likuiditetit (vazhdim)**

Ndarja sipas maturimit të pritsëm të aktiveve dhe detyrimeve monetare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 është si më poshtë. Kjo ndarje, aty ku nuk ka terma të përcaktuar pagese apo arkëtimi, është përcaktuar sipas gjykimit të manaxhimit.

	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1-5 vite	Totali
<b>Aktive monetare</b>					
Para në arkë dhe bankë	137,207,183	-	-	-	137,207,183
Llogari te arkëtueshme dhe të tjera	726,976,565	565,426,217	323,100,695	-	1,615,503,477
Parapagim i tatim fitimit	3,880,792	-	-	-	3,880,792
Hua paleve te treta	-	-	12,532,815	-	12,532,815
Parapagimet per aktive	-	5,848,271	-	-	5,848,271
Aktive të tjera	36,197,385	72,394,770	325,776,464	-	434,368,619
<b>Total</b>	<b>904,261,925</b>	<b>643,669,258</b>	<b>661,409,974</b>	<b>-</b>	<b>2,209,341,157</b>
<b>Detyrime monetare</b>					
Llogari të pagueshme	341,064,468	265,272,364	151,584,209	-	757,921,041
Hua dhe kredi të tjera	40,788,783	40,788,783	40,788,783	618,002,085	740,368,433
Të ardhura të shtyra	83,147,408	166,294,817	748,326,675	-	997,768,900
Detyrime të tjera afatshkurtra	6,263,740	1,356,980	112,910,082	-	120,530,802
<b>Total</b>	<b>471,264,399</b>	<b>473,712,944</b>	<b>1,053,609,749</b>	<b>618,002,085</b>	<b>2,616,589,176</b>
<b>Ekzpozimi</b>	<b>432,997,526</b>	<b>169,956,314</b>	<b>(392,199,775)</b>	<b>(618,002,085)</b>	
<b>Efkti kumulativ</b>	<b>432,997,526</b>	<b>602,953,841</b>	<b>210,754,066</b>	<b>(407,248,019)</b>	

**KASTRATI SH.P.K**

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

**28. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**28.3 Manaxhimi i riskut të likuiditetit (vazhdim)**

Ndarja sipas maturimit të pritshëm të aktiveve dhe detyrimeve monetare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 është si më poshtë:

	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1-5 vite	Totali
<b>Aktive monetare</b>					
Para në arkë dhe bankë	179,506,561	-	-	-	179,506,561
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	527,592,308	410,349,573	234,485,470	-	1,172,427,351
Parapagim i tatim fitimit	26,558,555	-	-	-	26,558,555
Hua paleve të treta	-	-	42,719,147	-	42,719,147
Parapagimet për aktive	-	5,927,574	-	-	5,927,574
Aktive të tjera	22,865,115	45,730,229	205,786,030	-	274,381,374
<b>Total</b>	<b>756,522,539</b>	<b>462,007,376</b>	<b>482,990,647</b>	<b>-</b>	<b>1,701,520,562</b>
<b>Detyrime monetare</b>					
Llogari të pagueshme	518,608,879	403,847,828	230,770,188	-	1,153,226,895
Hua dhe kredi të tjera	40,788,783	40,788,783	40,788,783	356,862,085	479,228,434
Të ardhura të shtyra	55,715,078	111,430,156	501,435,703	-	668,580,937
Detyrime të tjera afatshkurtra	6,263,740	4,818,262	127,500,000	-	138,582,002
<b>Total</b>	<b>621,376,480</b>	<b>560,885,029</b>	<b>900,494,674</b>	<b>356,862,085</b>	<b>2,439,618,268</b>
<b>Ekzpozimi</b>	<b>135,146,059</b>	<b>(98,877,653)</b>	<b>(417,504,027)</b>	<b>(356,862,085)</b>	
<b>Efekti kumulativ</b>	<b>135,146,059</b>	<b>36,268,406</b>	<b>(381,235,621)</b>	<b>(738,097,706)</b>	

## 29. Angazhime dhe pasiguri

### Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

## 30. NGJARJE PAS PERIUdhËS RAPORTUESE

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj..) dhe fitimi mund të ndikohen. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 5 të këtyre pasqyrave financiare.

Pas datës së pasqyrave financiare, nuk ka pasur ngjarje për të cilat të nevojiten rregullime në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

